



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2022:086012
Datë: 20.10.2023
Numri i dokumentit: 04808408

PPP.nr.98/22

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, Departamenti i përgjithshëm, Divizioni civil, gjyqtari Faton Ajvazi, me sekretaren juridike Makfire Reçica, në çështjen përbarimore të kreditorit F. SH.P.K, me seli në fsh ..., Komuna e Ferizajt, të cilin e përfaqëson përfaqësuesi ligjor Sh.Q. nga Ferizaj, e këtë e përfaqëson av Edison Simani nga Vitia, kundër debitorit A.A. nga Shtimja, rr "...", nr....., të cilin e përfaqëson av Faton Neziraj nga Shtimja, për pagesën e borxhit, duke vendosur për prapësimin e ushtruar nga i autorizuari i debitorit, më datë 20.10.2023, mori këtë:

A K T V E N D I M

I.PRANOHET në tërësi si i bazuar prapësimi i të autorizuarit të debitorit A.A., i ushtruar kundër urdhrin për përbarim P.nr.85/22, të datës 06.04.2022, i lëshuar nga Përbaruesi privat P.Xh. nga Gjilani dhe **SHFUQIZOHET** në tërësi urdhri për përbarim P.nr.85/22, i datës 06.04.2022, si dhe **ANULOHEN** në tërësi veprimet e kryera përbarimore sipas urdhrin P.nr.85/22, të datës 06.04.2022.

II.DETYROHET kreditori F. SH.P.K, që debitorit A.A., t'ia paguaj shpenzimet për përpilimin e prapësimit në shumë prej 312 euro, në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktvendimi, nën kërcënimin e përbarimit me dhunë.

A r s y e t i m

Përbaruesi Privat P.Xh., duke vepruar sipas propozimit për përbarim të dorëzuar nga kreditori F. SH.P.K, me urdhrin P.nr.85/22, të datës 06.04.2022 e ka caktuar përbarimin ndaj debitorit A.A., për pagesën e borxhit ndaj kreditorit në shumë prej 46.850.00 euro dhe

shpenzimet për përpilimin e propozimit për përmbarim në shumë prej 312 euro, si dhe shpenzimet tjera të përmbarimit, në pajtim me udhëzimin e administrativ Nr.06/2014, në bazë të Kontratës për Shitblerjen e Paluajtshmërisë-Banesës dhe Garazhës, LRP.nr.4...2/2017, Ref.nr.1...3/2017, e datës 06.12.2017, ose bllokimin e të gjitha llogarive bankare nëpër të gjitha bankat komerciale në Kosovë, ndalimin e mjeteve në para të cilat i ka debitori në llogaritë bankare në të gjitha bankat komerciale.

Kundër urdhrimit mbi lejimin e përmbarimit, në afatin ligjor, ka ushtruar prapësim i autorizuari i debitorit, me të cilin i ka propozuar gjykatës që të aprovohet prapësimi si i bazuar.

I autorizuari i kreditorit ka ushtruar përgjigje me shkrim në prapësimin e debitorit, me të cilën i ka propozuar gjykatës që prapësimi i debitorit të refuzohet si i pabazuar.

Gjykata me rastin e shqyrtimit të pretendimeve në prapësim të autorizuarit të debitorit dhe shkresave të lëndës, gjeti se:

Prapësimi i debitorit është i bazuar

Sa i përket pretendimeve të autorizuarit të debitorit në prapësim se nga ana e kreditorit është paraqitur propozimi për përmbarim përkundër faktit se është në dijeni se borxhi i kërkuar është likuiduar ashtu si e parashohin dispozitat ligjore të nenit 276, nenit 286, 299 dhe nenit 301, të LMD-së, dhe pas lidhjes së para kontratës debitori ka përmbushur të gjithë detyrimin ashtu si edhe ishte kontraktuar përkundër faktit se kreditori asnjëherë deri më sot nuk e ka përfunduar objektin në fjal dhe debitori detyrimin e tij monetar e ka likuiduar ashti si ishte kontraktuar për çka edhe posedon dëftesat – transfer dërgesat në emër të kreditorit, transfer dërgesën e datës 31.05.2018, në emër të përfituesit F. SH.P.K, me pagesë në vlerë prej 12,500 euro, transfer dërgesën e datës 04.06.2018, me pagesë prej 9,350.00 euro, transfer dërgesën e datës 06.06.2018, në emër të përfituesit F. SH.P.K, me pagesë në vlerë prej 8,000.00 euro, transfer dërgesën e datës 08.06.2018, me pagesë në vlerë prej 11,000.00 euro dhe transfer dërgesën e datës 12.06.2018, në emër të përfituesit F. SH.P.K, me pagesë në vlerë prej 6,000.00 euro, gjithsejtë 5 transfere në BPB, në vlerë të përgjithshme prej 48,850.00 euro, gjykata këto pretendime i konsideron të bazuara sepse nga provat të cilat i autorizuari i debitorit i ka bashkangjitur prapësimin të tij dhe të propozuar në prapësim, siç janë : fletë transferi i datës 12.06.2018, fletë transferi i dt. 08.06.2018, fletë transferi i dt. 04.06.2018 dhe fletë transferi

i dt. 31.05.2018, të cilave gjykata ja ka falur besimin e plotë të provave, konstatohet se debitori A.A. para nxjerrjes së urdhrin për përbarim P.nr.85/22, të dt.06.04.2022 nga Përbaruesi privat P.Xh., e ka përmbushur në tërësi detyrimin e tij i cili rrjedhë nga kontrata LRP.nr.4...2/2017, dhe Ref.nr.1...3/2017, të dt. 06.12.2017 në vlerë të përgjithshme prej 46,850 euro, dhe me këtë gjykata konstaton se përbaruesi privat gabimisht ka vendosur kur e ka lejuar përbarimin e propozuar nga kreditori me nxjerrjen e urdhrin për përbarim P.nr. 85/22 të dt. 06.04.2022.

Si përfundim, gjykata vlerëson se duke i marr për bazë të gjitha faktet e përmendura më lartë gjeti se urdhri për përbarim i nxjerr nga përbaruesi privat P.Xh. me numër P.nr.85/22, i dt. 06.04.2022, është marr në kundërshtim me gjendjen faktike, gjegjësisht pas përmbushjes së plotë të detyrimit nga debitori në raport me kreditorin, andaj edhe gjykata për këtë arsye e pranoj në tërësi si të bazuar prapësimin e të autorizuarit të debitorit , e shfuqizoj urdhrin për përbarim të cekur më lartë si dhe i anuloj në tërësi veprimet e kryera në bazë të këtij urdhri.

Gjykata me rastin e detyrimit të kreditorit që debitorit ti paguaj shpenzimet e përpilimit të prapësimin në shumë prej 312 euro është bazuar në nenin 13 par, 5, të LPP-së, në të cilin shprehimisht është paraparë “Kreditori duhet ti kompensoj debitorit shpenzimet e shkaktuara pa nevojë të justifikueshme”.

Andaj, gjykata duke i marr parasysh thëniet e të autorizuarit të debitorit në prapësim, thëniet e të autorizuarit të kreditorit në përgjigjen në prapësimin e debitorit, si dhe shkresat tjera të lëndës, vendosi që prapësimin e të autorizuarit të debitorit ta pranoj në tërësi si të bazuar, ta shfuqizoj urdhrin mbi lejinin e përbarimit P.nr.85/22, të datës 06.04.2022, si dhe i anuloj në tërësi veprimet e ndërmarra sipas urdhrin për përbarim.

Nga të cekurat më lart dhe bazuar në nenin 73, par 1, 2 dhe 3, të LPP-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ

PPP.nr.98/22, më datë 20.10.2023

GJYQTARI

Faton Ajvazi

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktvendimi mund të ushtrohet ankesë Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate, në afatin prej 7 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktvendimi.